



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Ekstrakt

Nga procesverbali i mbajtur në takimin e Ekzekutivit të Komunës me qytetarët e fshatit Majac dhe fshatrave për rreth, mbajtur më dt.18.06.2020.

Takimi filloi në orën 15:32, dhe u mbajt në SHFMU “Drita”, në fshatin “Majac”.

Takimin e hapi dhe e kryesoi z.Sejdi Kamberi përfaqësues i fshatit “Majac”, fillimisht shpreh falënderimet sa i përket investimeve në fshat, falënderon gjithë të pranishmit dhe para pjesëmarrësve prezanton Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës së Podujevës dhe atë: Isuf Latifi drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, i shoqëruar nga Vezir Januzi drejtor Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural, Hamdi Jaha drejtor Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Faik Muçiqi drejtor Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Durim Salihu Drejtoria e Inspeksionit.

Pjesëmarrësit tjerë në këtë takim janë evidentuar dhe nënshkruar në listën për pjesëmarrje e cila është pjesë e këtij procesverbali.

Tema: Dëgjim Buxhetor rreth përgatitjes së propozim Buxhetit të Komunës për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021/23.

z.Sejdi Kamberi përfaqësues i fshatit “Majac”, fillimisht shpreh falënderimet sa i përket investimeve në fshat, falënderon gjithë të pranishmit për pjesëmarrje që e vlerëson mjaft të rëndësishëm këtë takim për lokalitetin e kësaj ane, njofton gjithë të pranishmit se Komuna e Podujevës zhvillon si çdo vit edhe këtë vit procesin e përgatitjes së projektbuxhetit për vitin e ardhshëm dhe prioritetet për dy vitet në vijim dhe prezanton para të pranishmëve Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës së Podujevës dhe atë: Isuf Latifi drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, i shoqëruar nga Vezir Januzi drejtor Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural, Hamdi Jaha drejtor Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Faik Muçiqi drejtor Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Durim Salihu Drejtoria e Inspeksionit, si dhe paraqet kërkesë për ndriçimin e fshatit dhe asfaltimin e rrugës te livadhet dhe fjalën ia kalon.

z. Isuf Latifi DBF, falënderoi të gjithë për pjesëmarrjen jep sqarime parafolësit, prej 15 maj fillon planifikimi i buxhetit për tri vite sot kemi ardhë të bisedojmë me ju për kërkesat e juaja që keni që ti fusim në projekt buxhet për vitin 2021, në kuadër të mundësive buxhetore mundohemi që ti shohim prioritetet që duhet të investohen në vitin 2020-2021, nuk kisha dashtë me zgjatë më shumë që ka dikush ndonjë kërkesë urdhëroni në mënyrë që bashkarisht të koordinohemi për projektet në vijim.

z.Florim Shabani nga fshati “Majac”, kërkon informatë lidhur me asfaltimin e rrugës.

z.Hamdi Jaha, drejtor DPUMM jep sqarime parafolëseve, këtë vit në fshatin “Majac”, janë në projekt për t’u asfaltuar rrugët në lagjet “Maloku” dhe “Retkoceri”, ne kërkojmë që në vitin 2021 të rritet buxheti dhe të asfaltohen rrugët të cilat kanë mbet.

Në lagjen e “Krasniqëve” këtë vit për shkak të pandemisë “Covid-19”, kemi mbet pa finalizimin e projekteve të parapara deri më tani.

z.Samet Berisha, nga fshati “Majac”, përfaqësues i lagjes “Lushaku”, paraqiti kërkesat:

-Shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit.

-Asfaltimin e rrugës.

-Shtrirjen e rrjetit të kanalizimit.

z.Faik Muçiqi, drejtor DSHPMSh jep sqarime parafolësit, rrjeti i kanalizimit është në projekt pritet fillimi i punimeve.

z.Hamdi Jaha, drejtor DPUMM jep sqarime parafolësit, ky vit nuk e mbulon buxhetin, shkaktar është gjendja e krijuar si pasojë e pandemisë “Covid-19”, vitin e ardhshëm do ta kemi prioritet këtë rrugë. Në fshatin “Majac” dhe fshatrat për rreth prioritet kemi rrugët në lagjet “Maloku” dhe rrugën në drejtim të urës.

z.Naim Krasniqi nga fshati “Majac”, përfaqësues i lagjes së “Vocollëve”, paraqet kërkesë për asfaltimin e rrugës së lagjes “Vocolli”.

z.Hamdi Jaha, drejtor DPUMM jep sqarime parafolësve, vitin e ardhshëm do të kemi buxhet më të madh dhe do ta kemi në prioritet çdo fshat çdo lagje në Komunën e Podujevës, do të bëjmë maksimumin që këto dy ose tri vite do të përfundojmë gjithë infrastrukturën rrugore në fshatin tuaj.

z.Muhamet Murati nga fshati “Popovë” përfaqësues i fshatit paraqiti kërkesat:

-Asfaltimin e tri rrugëve me gjatësi 1 km të tri lagjeve “Murati”, “Rexha” dhe “Hoxha”.

-Ndërtimin e një ure dhe kanalit e ujitjes në lagjen “Hoxha”.

-Asfaltimin e rrugës deri në “Segaç” në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës.

z.Hamdi Jaha, drejtor DPUMM jep sqarime parafolësit, nuk kemi mundësi buxhetore për asfaltimin e asaj rruge, do të tentojmë që me zhavorr ta shtrojmë aty ku ka nevojë do të dalim në terren ti shikojmë rrugët që kanë prioritet në çdo pjesë të fshatrave.

z.Arton Menxhiqi nga fshati ‘Lupç i Epërm’, paraqiti kërkesë për zgjerimin e shtratit të lumit i cili po dëmton tokat bujqësore dhe rrugën e fshatit.

z. Faik Muçiqi, drejtor DSHPMSh jep sqarime parafolësit, do rishikojmë mundësitë që ta evitojmë problemin e lumit dhe dëmtimin e gypave të rrjetit të kanalizimit në lum.

z.Ahmet Gashi drejtor i shkollës “Drita” fshati “Majac”, paraqiti kërkesat:

-Ndriçimin e fshatit.

-Projekt për ujitjen e tokave bujqësore.

-Kryçjen e shkollës në rrjetin e kanalizimit.

z.Vezir Januzi drejtor DBPZHR ndër të tjera theksoi, fokusi në i rëndësishëm është fusha e bujqësisë, “Majaci” me rrethinë kanë qenë bujq të vyeshëm, në vitin e kaluar kemi ndërtuar pesë penda në lumin “Llap”. Këtë vit kemi vizituar fshatin “Lupç” me kryetarin dhe kemi parë për prioritet ndërtimin e pendës në fshatin “Lupç” dhe në fshatin “Bajçinë”.

Për vitin tjetër kemi shumë kërkesa për ndërtimin e pendave andaj të bëhet një kërkesë me shkrim nga komuniteti i fshatit “Majac” për ndërtimin e pendës së fshatit “Majac” dhe në bazë të kërkesave të zgjedhim problemin e bujqve dhe fermerëve, në të gjitha projektet kapitale që të kemi një bujqësi të zhvilluar, kërkesat e juaja adresoni te ne dyert tona janë të hapura.

z.Muhamet Murati nga fshati “Popovë” përfaqësues i fshatit paraqiti kërkesë për ndërtimin e një kanali për ujitjen e tokës në fshatin “Popovë”.

z. Faik Muçiqi, drejtor DSHPMSh jepi disa sqarime lidhur me projektet, në fshatin “Majac”, kemi punuar bukur shumë për përfshirjen e të gjithëve në infrastrukturën rrugore për vitin e ardhshëm kemi planifikuar ndriçimin publik në rrugën kryesore për shkak të sigurisë së qytetarëve, nuk kemi mundësi buxhetore për shtrirjen e rrjetit të ndriçimit në fshatrat “Lupç i Epërm” dhe “Popovë”, besoi se 70% e këtyre rrugëve do të kenë ndriçim.

Në fshatin “Popovë” kemi planifikuar vendosjen e pllakës në urën e lagjes “Hoxha”.
Në fshatin “Lupç i Poshtëm” do të vazhdojnë punimet e trotuarit deri në maxhistrale vitin e ardhshëm.

z.Ahmet Gashi drejtor i shkollës “Drita” fshati “Majac” paraqiti kërkesë asfaltimin e rrugës së “Vaut” që është rrugë lidhëse mes fshatrave “Lupç” dhe “Majac”.

z.Sejdi Kamberi përfaqësues i fshatit “Majac”, ndër të tjera theksoi, në emër të kryesisë së fshatit ju falënderoi të gjithëve se jashtë zakonisht është punuar bukur shumë në fshatin “Majac” dhe fshatrat për rreth, kërkesa ime është për secilën lagje, parashtroni kërkesat me shkrim në drejtoritë përkatëse, ne i morëm të gjitha kërkesat e juaja dhe për disa veç se u dhanë sqarime, të përfshirjes së tyre në planifikimet tre vjeçare buxhetore të Komunës, andaj me kaq e konstatoi të mbyllur këtë takim.

Takimi përfundoi në orën 16:25.

Procesverbalin e mbajti:

Osman Bajrami

Nr.prot 04-400/01-0030193/20

Podujevë
18.06.2020

Drejtori i DBF
Isuf Latifi